



Komuna e Klinës

Kryetari i Komunës

01Nr. 112-2464 /2023

Klinë, dt. 23 /01/2023

Duke u bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr.03/L-040, botuar në gazetën zyrtare, nr. 28/2008 publikuar më dt.04.06.2008, dispozitat e nenit 90 të Ligjit, Nr.04/L-027 për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera, publikuar në Gazetën Zyrtare, nr.22/2011, dispozitat e nenit 9, 10 dhe 12 të Rregullores nr.17/2015 për Metodologjinë e Vlerësimit të Dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera, nenin 91 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Klinës të miratuar më datën 31.03.2010, më kërkesën e komisionit komunal- lokal për vlerësimin e dëmeve të themeluar sipas vendimit, nr.01-325-39855/2022 të datës 23.11.2022, Kryetari i Komunës së Klinës, **merr këtë;**

V E N D I M

1. **FORMOHET**, komisioni profesional për mbështetjen e komisionit lokal për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara në të mirat materiale nga fatkeqësitë natyrore- vërshimet në territorin e Komunës së Klinës.

Përbërja e komisionit është, siç vijon:

- 1.1. Arbërore Thaqi, kryesuese;
 - 1.2. Haki Bajraktari, anëtar;
 - 1.3. Arbër Raci, anëtarë;
 - 1.4. Luan Qerkinaj, anëtare;
 - 1.5. Burim Hoti, anëtarë.
2. Mandati i komisionit është i përkohshëm dhe përfundon më rastin e vlerësimit të dëmeve përkatësisht dorëzimit të Raportit komisionit lokal të vlerësimit.
 3. Komisioni si nga pika 1 e këtij vendimi detyrat dhe përgjegjësitë i ushtron, bazuar në Ligjin, nr.04/L-027 për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera, Rregulloren, nr.17/2015 për Metodologjinë e Vlerësimit të Dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera dhe autorizimeve të komisionit lokal.
 4. Komisioni në përputhje me dispozitat e Rregullores, përpilon Raportin për dëmet e vlerësuara në terrenet e përcaktuara nga komisioni lokal duke ja dorëzuar raportin më qellim të përfshirjes së tij në raportin përmbledhës komunal të dëmeve.
 5. Ky vendim është i plotfuqishëm dhe hynë në fuqi menjëherë.

Të njoftohen:

- Të përmendurit;
- Komisioni lokal për vlerësimin e dëmeve;
- Ekzekutivi;
- DSHPE;
- Zyra e Informimit, si dhe;
- Arkivi.

